

VENDIM
Nr. 22, datë 11.4.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 9.12.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 66/21, Akti që i përket

KËRKUESE: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i pjesës së fundit të fjalisë së parë të nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile, ku disponohet “përpara gjykatës që ka dhënë vendimin”.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 135 dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që kërkoi pranimin e kërkesës, propësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen civile me palë paditëse Degën Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave (EKB) kundër disa të paditurve, me vendimin nr. 1610, datë 25.5.2012, ka vendosur pranimin e padisë duke zgjidhur kontratën e shitjes me nr. 2519rep., datë 15.12.2000 dhe duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Ky gjykim është zhvilluar në mungesë të së paditurës K.K., e cila, me pretendimin se administrata gjyqësore nuk ka respektuar kërkesat ligjore për njoftimin e vendimit të dhënë në mungesë të palëve, ka paraqitur një kërkesëpadi me objekt pavlefsh-mërinë e aktit të njoftimit të vendimit përfundimtar. Kërkesëpadija është pranuar me vendimin nr. 2195, datë 4.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka vendosur edhe konstatimin e pavlefshmërisë së njoftimit.

2. Gjykata e Apelit Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin kundër vendimit nr. 2195, datë 4.10.2013, ka vendosur prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke caktuar si detyra rregullimin e ndërgjyqësisë, marrjen e provave shtesë për një hetim më të plotë për të provuar marrjen dijeni nga e paditura K.K. mbi vendimin nr. 1610, datë 25.5.2012, si dhe vlerësimin nëse pala paditëse legjitimohej në ngritjen e kërkesës për rivendosje në afat.

3. Në procesin e rigjyimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë gjatë fazës përgatitore ka vlerësuar kompetencën funksionale mbi kërkimin e shtuar në objektin e padisë mbi rivendosjen në afat të ankimit para gjykatës që ka dhënë vendimin, në kuptim të nenit 458 të KPC-së, që parashikon se “Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme mund të

paraqesin kërkesë për rivendosje në afat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të saj mund të bëhet ankimi i veçantë”.

4. Gjkata referuese, duke vlerësuar se togfjalëshi “*përpara gjykatës që ka dhënë vendimin*” bie ndesh me nenet 42/2 dhe 135 të Kushtetutës, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes, si dhe e ka referuar atë në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 458 të KPC-së.

II

5. *Gjkata referuese* pretendon se togfjalëshi “*përpara gjykatës që ka dhënë vendimin*”, i parashikuar në pjesën e fundit të fjalisë së parë të nenit 458 i KPC-së, cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj, atë të shqyrtimit gjyqësor sipas shkallëve të gjykimit, të shqyrtimit të ankimit brenda afatit të arsyeshëm dhe të sigurisë juridike. Argumentet në mënyrë të përmbledhur janë si vijon:

5.1 Gjkata e Rrethit Gjyqësor Vlorë legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues, pasi jurisprudenca kushtetuese, duke e interpretuar gjerësisht kuptimin e nenit 145/2 të Kushtetutës, i ka shtrirë efektet e tij edhe për çështjet e ndërmjetme me natyrë procedurale, të cilat mund të kenë ndikim në gjithë vijimësinë e procesit. Sipas gjykatës referuese, dispozitës së kundërshtuar nuk mund t’i jepet kuptim bazuar në metodën e interpretimit pajtues me Kushtetutën dhe jurisprudencën kushtetuese, por as mund ta shfuqizojë atë, pasi kjo bie ndesh me nenet 7, 131/a dhe 145/1 të Kushtetutës.

5.2 Togfjalëshi “*përpara gjykatës që ka dhënë vendimin*” i nenit 458 të KPC-së është në kundërshtim me nenet 42/2 dhe 135 të Kushtetutës, pasi bazuar në qëndrimin e mbajtur nga Gjkata Kushtetuese në vendimin nr. 31, datë 17.5.2012, mbi kuptimin e nenit 147 të KPP-së, kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata ku do të shqyrtohet ankimi dhe jo gjykata që ka dhënë vendimin.

5.3 Po ashtu, togfjalëshi i kundërshtuar cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse i jep gjykatës më të ulët autoritetin juridiksional dhe kushtetues të gjykatës së apelit ose të Gjykatës së Lartë, pasi vlerëson veprimtarinë e tyre procedurale dhe, për rrjedhojë, edhe të ligjshmërisë së vendimit apo të procedimit gjyqësor në tërësi.

5.4 Shfuqizimi i togfjalëshit “*përpara gjykatës që ka dhënë vendimin*” do të riparojë qëndrimin jokushtetues të vendimit unifikues penal nr. 1/2013 dhe do të evitojë mundësinë që një gjykatë e shkallës më të ulët t’i imponojë vendimmarrjen një gjykate të një shkallë më të lartë për sa i takon interpretimit të ligjit, por edhe mënyrës së vlerësimit të provave.

5.5 Zgjidhja kushtetuese mbi nenin 458 të KPC-së do të ndreqë edhe situatën tjetër procedurale që lidhet me njëkohshmërinë e paraqitjes dhe të shqyrtimit të ankimit e të kërkesës për rivendosje në afat në gjykatën që ka dhënë vendimin. Në këtë kuptim rivendosja në afat të ankimit proceduralisht përbën një çështje paragjykimore brenda çështjes së themelit dhe për nga ana vendimmarrëse përbën një vendim të ndërmjetëm të gjykatës së apelit ose të Gjykatës së Lartë.

5.6 Gjithashtu, si pasojë e shfuqizimit të togfjalëshit të kundërshtuar do të respektohen edhe dy standarde të tjera kushtetuese, konkretisht afati prekluziv i ankimit, që implikon sigurinë juridike të ndërgjygjësve, si dhe afati i arsyeshëm, në referim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6. *Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi)* nuk ka paraqitur prapësime me shkrim lidhur me çështjen, megjithëse ka pasur dijeni për kohën e zhvillimit të gjykimit kushtetues.

7. *Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë*, ka prapësuar me shkrim si vijon:

7.1 Gjkata referuese nuk ka përcaktuar mjaftueshmërisht objektin e çështjes, nuk ka identifikuar në terma ligjorë objektin e çështjes dhe nuk ka parashtruar shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i pjesës së fundit të fjalisë së parë të nenit 458 të KPC-së. Argumentet e parashtruara nga gjykata referuese lidhen me çështje të interpretimit dhe unifikimit të ligjit dhe nuk provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë të normës së kundërshtuar me zgjidhjen e çështjes nga gjykata referuese.

7.2 Pretendimi i gjykatës referuese se neni 458 i KPC-së e detyron gjykatën më të lartë t'i bindet vlerësimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykata më e ulët është i pabazuar, për faktin se vendimi i dhënë nga kjo e fundit i nënshtrohet kontrollit gjyqësor hierarkik. Togfjalëshi "gjykata që ka dhënë vendimin" duhet të nënkuptojë gjykatën që është caktuar nga sistemi gjyqësor për përfundimin e akteve përkatëse të nevojshme për përfundimin e fazës që gjendet para saj. Kur kërkesa për rivendosje në afat refuzohet në gjykatën e shkallës së parë, ankimi kundër këtij vendimi paraqitet në gjykatën e apelit, dhe më pas, në Gjykatën e Lartë.

7.3 Gjikata referuese në rastin konkret e keqinterpreteton nenin 458 të KPC-së, pasi ky nen nuk përcakton që kërkesa për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, sepse kompetenca përcaktohet sipas rastit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

8. Çështja e legjitimitimit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese (Gjikata) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, që parashikon se *"kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese"*. Ndërsa, sipas nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, *"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese"*, gjykata apo gjyqtari, kur çmon se ligji është antikushtetues, është i detyruar të argumentojë para Gjykatës Kushtetuese ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete *(shih vendimin nr. 50, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

9. Gjikata në vazhdimësi ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajftueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të parashtrojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën *(shih vendimet nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë kuptim është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret *(shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 39, datë 30.6.2014; nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjikata vëren se gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin e togfjalëshit *"përpara gjykatës që ka dhënë vendimin"* të nenit 458 të KPC-së, me argumentin se cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj, atë të hierarkisë së shqyrtimit gjyqësor sipas shkallëve të gjyimit, të shqyrtimit të ankimit brenda afatit të arsyeshëm, si dhe të sigurisë juridike.

11. Gjikata, bazuar në detyrimin që buron për gjykatën referuese për parashtrimin e "arsyeve serioze për antikushtetutshmëri", vlerëson të analizojë nëse argumentet e paraqitura në kërkesë janë të mjaftueshme për të provuar, në nivel kushtetues, shkeljen e parimeve të evidentuara më lart.

12. Në referim të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata rithekson se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues. Gjykata vëren se argumentet e parashtruara nga kërkuuesja për shfuqizimin e togfjalëshit lidhen me qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 31, datë 17.5.2012, si dhe me qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (KBGJL-të) mbi nenin 147 të KPP-së në vendimin unifikues nr. 1/2013.

13. Gjykata konstaton se kërkuuesja nga njëra anë arsyeton që neni 458 i KPC-së është i qartë rreth kriterit që ndjek për atribuimin e kompetencës funksionale, sepse praktika gjyqësore më e lartë e ka sheshuar sigurinë dhe mënyrën sesi do të kuptohet togfjalëshi *“gjykata që ka dhënë vendimin”*, kurse nga ana tjetër, argumenton se qëndrimi i mësipërm ka ndryshuar pas marrjes të vendimit nr. 31, datë 17.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese, të cilin e vlerëson të detyrueshëm për referim në çështjen konkrete.

14. Bazuar në legjislacionin procedural shqiptar dhe në praktikën gjyqësore, Gjykata vëren se rivendosja në afat është një mjet procedural që ka si qëllim garantimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit nga palët në proces ndaj një vendimi gjyqësor, në ato raste, të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligjvënësi, kur ata nuk kanë pasur mundësi që ta ushtrojë këtë të drejtë brenda afatit ligjor.

15. Në Kodin e Procedurës Civile rivendosja në afat e së drejtës së ankimit rregullohet nga neni 458, që parashikon se *“Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të saj mund të bëhet ankim i veçantë”*. Në Kodin e Procedurës Penale, ky mjet procedural ka gjetur rregullim në nenin 147, ku midis të tjerash, përcaktohet: *“4. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj. 5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar. 6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim.”*.

16. Gjykata në vendimin e saj nr. 31, datë 17.5.2012 e ka analizuar çështjen e kompetencës funksionale të gjykatës ku paraqitet kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit në procesin penal në dritën e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Ajo ka vlerësuar se *“... shprehja “organi që procedon” i referohet organit që ka dhënë vendimin ndaj të cilit kërkon të ankohet i gjykuari. Pra nëse i gjykuari kërkon të ushtrojë ankim ndaj vendimit të apelit, kërkesën për rivendosje në afat duhet ta shqyrtojë gjykata e apelit...”*. Për sa i takon së drejtës së palëve për të kundërshtuar vendimin që ka lejuar ose ka refuzuar rivendosjen në afat, Gjykata e ka analizuar atë në dy aspekte: a) ankimi ndaj vendimit të pranimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili bëhet bashkë me vendimin përfundimtar; dhe b) ankimi ndaj vendimit të refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili është i veçantë dhe paraqitet në gjykatën më të lartë, sipas rastit, pasi organi që procedon në raste të ndryshme mund të jetë i ndryshëm.

17. Në rastin e nenit 458 të KPC-së, Gjykata vëren se për sa i takon kompetencës funksionale të gjykatës që ka dhënë vendimin për të shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat, në praktikën gjyqësore civile nuk ka pasur dyshime lidhur me kuptimin e togfjalëshit *“gjykata që ka dhënë vendimin”* dhe ndikimin e tij në cenimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor, kjo për faktin se togfjalëshi nuk ka krijuar paqartësi lidhur me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit.

18. Gjykata vlerëson se togfjalëshi *“gjykata që ka dhënë vendimin”* duhet kuptuar: gjykata që ka shpallur vendimin ndaj të cilit palët nuk kanë mundur të ushtrojnë ankim brenda afatit ligjor. E thënë ndryshe, nëse palët kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit (apelit) ndaj vendimit të dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor, kompetente për shqyrtimin e kërkesës është vetë ajo gjykata. Në rast se palët do të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit (rekursit) ndaj vendimit të dhënë nga gjykata e apelit, kompetente për shqyrtimin e kërkesës është gjykata e apelit. Në lidhje me të drejtën e ankimit, Gjykata vëren se ligjvënësi ka parashikuar të drejtën e ushtrimit të një ankimi të veçantë ndaj vendimit për rivendosjen në afat për të dyja palët, pa e lidhur ushtrimin e ankimit të veçantë me ankimin kundër vendimit përfundimtar.

19. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se gjykata referuese nuk ka dhënë argumente bindëse dhe arsye serioze për sa i përket cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të hierarkisë së shqyrtimit gjyqësor sipas shkallëve të gjykimit, të shqyrtimit të ankimit brenda afatit të arsyeshëm, si dhe të sigurisë juridike. Në parashtrimet e gjykatës referuese mungojnë shkaqe dhe argumente të cilat mund të justifikonin pretendimet për papajtueshmëri me Kushtetutën të togfjalëshit “gjykata që ka dhënë vendimin”. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pretendimet nuk janë ngritur në nivel kushtetues, sepse nuk i takon juridiksionit kushtetues zgjidhja e problemeve që rrjedhin nga keqinterpretimi i tekstit të dispozitës apo kuptimi i ndryshëm që gjykata referuese i ka dhënë asaj.

20. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson qëndrimin se është e domosdoshme që gjykata referuese përpara se të pezullojë procesin gjyqësor dhe të kërkojë kontrollin incidental të normës juridike, duhet të verifikojë nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse nuk ka, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën, me qëllim garantimin e dhënies së drejtësisë efektive.

21. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjykata referuese), bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, i është drejtuar kësaj Gjykate për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të togfjalëshit “*përpara gjykatës që ka dhënë vendimin*” në fund të fjalisë së parë të nenit 458 të KPC-së, sipas të cilit “kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin”. Gjykata referuese pretendon se ky togfjalësh cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj, atë të shqyrtimit gjyqësor sipas shkallëve të gjykimit, të shqyrtimit të ankimit brenda afatit të arsyeshëm dhe të sigurisë juridike.

2. Sipas gjykatës referuese, duke ju referuar qëndrimin të mbajtur nga kjo Gjykatë në vendimin nr. 31, datë 17.5.2012, lidhur me nenin 147 të KPP-së, kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata ku do të shqyrtohet ankimi dhe jo gjykata që ka dhënë vendimin, prandaj për analogji edhe togfjalëshi “*përpara gjykatës që ka dhënë vendimin*” i nenit 458 të KPC-së bie në kundërshtim me nenet 42/2 dhe 135 të Kushtetutës. Gjithashtu, gjykata referuese parashtron se ajo e ka të pamundur të bëjë vetë interpretim pajtues të dispozitës së kundërshtuar me Kushtetutën apo me jurisprndencën kushtetuese.

3. Shumica në arsyetimin e saj, ndër të tjera, ka konstatuar se në rastin e nenit 458 të KPC-së në praktikën gjyqësore civile nuk ka pasur dyshime lidhur me kuptimin e togfjalëshit “*gjykata që ka dhënë vendimin*”, për faktin se ky togfjalësh nuk ka krijuar paqartësi lidhur me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit. Në këtë kontekst,

shumica ka vlerësuar se togfjalëshi “*gjkata që ka dhënë vendimin*” duhet kuptuar: gjykata që ka shpallur vendimin ndaj të cilit palët nuk kanë mundur të ushtrojnë ankim brenda afatit ligjor. E thënë ndryshe, nëse palët kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit (apelit) ndaj *vendimit të dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor*, kompetente për shqyrtimin e kërkesës është vetë ajo gjykatë. Në rast se palët do të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit (rekursit) ndaj *vendimit të dhënë nga gjykata e apelit*, kompetente për shqyrtimin e kërkesës është *gjkata e apelit (shih paragrafët nr. 17–18 të vendimit të shumicës)*.

4. Pavarësisht këtij vlerësimi, që në fakt lidhet me themelin e çështjes, shumica në kontradiktë me veten arrin në dy përfundime diametralisht të kundërta: a) se Gjkata e Rrethit Gjyqësor Vlorë *nuk legjitimohet* për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues, pasi ajo *nuk ka dhënë argumente bindëse dhe arsye serioze* për sa i përket cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të hierarkisë së shqyrtimit gjyqësor sipas shkallëve të gjykimit, të shqyrtimit të ankimit brenda afatit të arsyeshëm, si dhe të sigurisë juridike; b) se pretendimet e gjykatës referuese *nuk janë ngritur në nivel kushtetues*, sepse nuk i takon juridiksionit kushtetues zgjidhja e problemeve që rrjedhin nga keqinterpretimi i tekstit të dispozitës apo kuptimi i ndryshëm që gjykata referuese i ka dhënë asaj (*shih paragrafët nr. 19–21 të vendimit të shumicës*).

5. Mendoj se qëndrimet e shumicës, duke iu shmangur thelbit të problemit të shtruar para kësaj Gjykate për zgjidhje, krijojnë paqartësi si në raport me jurisprudencën kësaj Gjykate, ashtu edhe në praktikën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

6. Në një rast analog, sikurse u përmend më lart, Gjkata, në vendimin nr. 31, datë 17.5.2012, ka legjitimuar Gjykatën e Lartë (gjkata referuese në atë çështje) për kontrollin e anti-kushtetutshmërisë të nenit 147 të KPP-së, i cili parashikon të njëjtin mjet procedural (rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit) në procesin penal dhe ka shqyrtuar themelin e çështjes. Më konkretisht, Gjkata, duke analizuar çështjen e kompetencës funksionale të gjykatës ku paraqitet kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit në procesin penal në dritën e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, ka vlerësuar se “... *shprehja “organi që procedon” i referohet organit që ka dhënë vendimin ndaj të cilit kërkon të ankohet i gjykuari. Pra, nëse i gjykuari kërkon të ushtrojë ankim ndaj vendimit të apelit, kërkesën për rivendosje në afat duhet ta shqyrtojë gjykata e apelit...*”.

7. Nisur nga kjo praktikë e Gjykatës mendoj se shumica, duke mbajtur parasysh rëndësinë që paraqet kërkesa për kontroll incidental për respektimin e parimit të ndarjes e balancimit të pushteteve dhe të funksionimit normal të shtetit të së drejtës, duhet të vinte në diskutim dhe t’u jepte fillimisht përgjigje disa çështjeve:

7.1. Nëse gjendej përpara një situatë juridike të njëjtë me atë të vendimarrjes së mëparshme, në respekt të jurisprudencës së saj.

7.2. Nëse gjykata referuese mund të bënte një interpretim pajtues të nenit 458 të KPC-së, mbështetur në vendimin nr. 31, datë 17.5.2012 që i referohet kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit në procesin penal.

8. Personalisht jam i mendimit se në kushtet e një vendimarrjeje të kësaj Gjykate mbi të njëjtin mjet procedural, kur dispozitat paraqiten me formulime të ngjashme, për të evituar praktika të ndryshme, të cilat krijojnë paqartësi që çojnë në cenimin e parimit të sigurisë juridike, shumica duhet ta shqyrtonte në themel çështjen.

9. Gjithashtu, çmoj se edhe në parim dispozita në shqyrtim shfaq probleme lidhur me interpretimin e saj në pajtim me jurisprudencën kushtetuese, çka konfirmohet edhe në vetë vendimin e shumicës, e cila, sikurse u përmend më lart, edhe pse ka arritur në përfundimin se gjykata referuese nuk legjitimohet në kërkimin e saj, *de facto* i ka hyrë themelit të çështjes, duke interpretuar nenin 458 të KPC-së nën dritën e vendimit nr. 31, datë 17.5.2012 të kësaj Gjykate.

10. Nga ana tjetër, duke qenë se gjendemi përpara fushave të ndryshme (civile dhe penale), në ndryshim nga shumica, çmoj se gjykata referuese nuk mund të bënte një interpretim pajtues të normës (nenit 458 të KPC-së) me jurisprudencën kushtetuese. Për këto arsye, me të drejtë ajo i është drejtuar kësaj Gjykate për kontrollin e papajtueshmërisë së normës.

11. Për sa më sipër, jam i mendimit se vendimmarrja e shumicës, për këtë kërkim të gjykatës referuese, krijon paqartësi në institutin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit në fushën civile në krahasim me atë penale, si dhe vendos dy standarde edhe në lidhje me jurisprudencën e lartpërmendur së kësaj Gjykate.

Anëtar: Vladimir Kristo